

Anton Dukagjini

Mban pozicionin e Drejtorit të Arkivit prej korrik të vitit 2023, pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit.

Është diplomuar pranë Universitetit të Tiranës, në shkencat Shoqërore, profili Gjuhë e Huaj si dhe është diplomuar në shkenca juridike dhe Master Shkencor në të Drejtë Penale.

Në karrierën e tij profesionale, ka punuar si Specialist për një periudhë të gjatë në institucionin e Kuvendit të Shqipërisë, duke mbuluar pozicionet lidhur me shfrytëzimin dhe përpunimin e dokumentit arkivor, punën me informacionin e klasifikuar dhe detyra të tjera. Gjithashtu ka punuar edhe në sektorin privat. Pranë Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit që prej vitit 2017 ka mbajtur pozicionet si Specialist, më pas Përgjegjës i Sektorit të Ruajtjes së Fondeve në Drejtorinë e Arkivit e aktualisht si Drejtor i Drejtorisë së Arkivit.

Z. Dukagjini, ka kryer trajnime brenda dhe jashtë vendit në fushën e arkivave, punën me dokumentet e klasifikuar “sekret Shtetëror”.

Drejtoria e Arkivave përgjigjet për :

1. Drejtoria e Arkivit është në varësi të drejtpërdrejtë të Autoritetit dhe të Sekretarit të Përgjithshëm, drejtohet nga Drejtori i Arkivit dhe është përgjegjëse për:
 - a) grumbullimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për qëllimet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 45/2015;
 - b) vlerësimin, renditjen, evidentimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve, sipas rregullave dhe parimeve të legjislacionit në fuqi për arkivat.
 - c) bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me autoritetet publike dhe arkivat.
 - d) jep për përdorim dosjet dhe dokumentet arkivore, në vijim të kërkesave për informim të paraqitura nga institucionet dhe shtetasit;
 - e) jep materialet arkivore për shfrytëzim sipas ligjit dhe rregullores së Autoritetit përkundrejt regjistrimit të interesuarve etj
2. Drejtoria ka në përbërje këto sektorë:
 - Sektori i ruajtjes së fondeve
 - Sektori i përpunimit
 - Sektori i kartotekës